

KLSH merr pjesë në takimin e mbajtur në Prishtinë në kuadër të Auditimit të Përbashkët të Performancës me temë “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”.

Në vijim të angazhimit që KLSH ka marrë së bashku me SAI-t e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut si dhe në bashkëpunim me UN Women Albania për të zhvilluar auditimin e përbashkët me temë “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”, në datat 16-17 Tetor 2023, u zhvillua në Prishtinë takimi rajonal ku morën pjesë grupet e auditimit të secilit SAI si dhe përfaqësues të UN Women nga vendet pjesë e këtij projekti.

Takimi u organizua nga UN Women dhe objektivi kryesor i tij ishte diskutimi ndërmjet grupeve të auditimit për rezultatet përfundimtare të fazës studimore, si dhe gjetjet potenciale. Në këtë takim KLSH u përfaqësua nga grupi i auditimit, znj. Ermira Vojka, përgjegjëse e grupit të auditimit, znj. Arminda Bushi dhe Juorida Zhegu anëtare.

Secili grup prezantoi rezultatet e punës të kryer deri në këtë fazë të auditimit. Në prezantimin e bërë nga znj. Vojka u paraqitën fokusi dhe objektivat e auditimit si dhe drejtimet kryesore ku do të fokusohet auditimi në fazën e terrenit. Për secilin drejtim të auditimit u paraqitën gjetjet potenciale të cilat do të analizohen më tej.

Grupet e auditimit, pas prezantimeve përkatëse, diskutuan dhe shkëmbyen mendime rreth gjetjeve paraprake. Në këto diskutime u përfshinë edhe ekspertët e UN Women të cilët dhanë sugjerimet e tyre lidhur me rëndësinë që kanë gjetjet e grupeve të auditimit në identifikimin e problematikave për punësimin e grave të zonave rurale.



Foto: UN Women Albania

Në përfundim, grupet e auditimit dhe pjesëmarrësit u dakordësuan në parim për vijimësinë e punës deri në takimin e ardhshëm.